

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. GENTJAN JAHJOLLI

01/09/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 08.01.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Jahjoll, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 09.01.2019 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Gentjan Jahjoll, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Etleda Çiftja relatore, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.